

ZVILLIMI I PRODUKTEVE TË TURIZMIT

Përshkrimi i aktiviteteve



AVENTURË NË NATYRË

Përshkrimi dhe elementet teknike

Akomodimet unike janë strehime origjinale që shkojnë përtej kornizës së zakonshme të banimit tradicional. Zakonisht gjenden në lokacione shumë të privileguara nga ana ekonomike, ku nuk ka pengesa.

Ky akomodim paraqitet në forma të ndryshme si: habitate nomadike, kabina, jetë e egër/natyrë, banim i nëndheshëm, projekte artistike, ndërtesa fetare, ndërtesa historike, lundrim, flluska, iglu...

Modeli i biznesit

Metoda e operimit është e ngjashme me 'bed and breakfast' apo me kampingun. Banesat jepen me qira për një natë. Implementimi i planeve të ushqimit varet nga pronarët.



Faktorët kryesorë të suksesit

Këto lloj akomodimesh vënë në pah thjeshtësinë, ndjenjën e shtëpisë dhe përvojën unike. Nocioni i komfortit është shumë i rëndësishëm. Ky akomodim i ofron klientit kontakt të privilegjuar me natyrën. Pronari angazhohet për turizëm të qëndrueshëm.

Risqet potenciale

Ndërtimi i tepruar, ndërtesa duhet t'i përshtatet ambientit që e rrethon dhe historisë së tij. Mund të shohim raste kur ndërtohen jurta nëpër Evropë, mirëpo kjo nuk ka kuptim nëse shikohet nga aspekti historiko-kulturor.



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË

Ku të implementohet?

Ky lloj produkti mund të zhvillohet në shumë vende, për sa kohë që peisazhi është i përshtatshëm për këtë. Sidoqoftë, kemi gjetur disa lokacione specifike ku mendojmë që zhvillimi i këtij produkti mund të jetë adekuat.



Liqeni i Gazivodës



Rajon i Shalës



Rahoveci

Qëndrueshmëria


Ekonomike

Qëndrimet një-natëshe mundësojnë zhvillimin e përfitimeve direkte dhe indirekte.



Ambientale

Kontakt i privilegjuar me natyrën.



Sociale

Krijimi i vendeve të punës.



Vegëza të dobishme

<https://domainedeladombes.com/lodge/la-cabane-libellule>
www.iglu-dorf.com/en/
<https://www.grotte-cocaliere.com/en/accommodation.html>
<http://www.treehotel.se/en/>
<http://www.kazinsolite.re/en>
<https://europe.huttopia.com/en/>
<http://www.postranchinn.com/accommodations/tree/>



Përshkrimi dhe elementet teknike

Kjo përvojë përfshin ecjen mbi pemë dhe argëtimin e sigurtë mbi rrjeta pa mbrojtëse, mbi ura këmbësorësh, trampolinat gjigande dhe labirinte. Instalacionet përbëhen nga module, ura këmbësorësh, rrëshqitëse dhe tunele. Secili modul varion nga 50 deri në 400 m². Për një park prej 1500 m² (~150 vizitorë në të njëjtën kohë), duhen së paku +/- 40 pemë me minimumi një diametër prej 30 centimetrash dhe të jenë 3 deri 16 metra larg njëra-tjetrës. Lartësia varion sipas diametrit të pemëve.

Modeli i biznesit

Investimi mesatar: 225 deri 300 mijë € (1250/1650 m²). Kthimi i investimit nga 1 deri 3 vite varësisht nga numri i vizitorëve. Përveç investimit fillestar, shtu krasitjen, analizat fitosanitare, dhe zyrën e kontrollit (kosto vjetore). Numri mesatar i vizitorëve: 40,000 në vit

Faktorët kyçë të suksesit

- Cilësia e projektimit (zgjedhja e pemëve, hijeshia e instalacioneve, variacionet e shtigjeve...)
- Aftësia e zhvillimit të aktiviteteve për periudhat jashtë sezonit: vrotimi i natyrës/zogjve, piknik nën pemë, lojëra, vrotim i yjeve, shfaqje filmash, etj.

Risqet potenciale

- Çështjet e sigurisë → vizita të sigurisë në baza të rregullta.
- Objekti duhet të mbyllet në rast të shtrëngatave apo erërave më të shpejta se 70 km/h.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Krijimi i vendeve të punës do të varet nga projekti (atraksioni i vendit të përzgjedhur dhe cilësia e infrastrukturës)



Ambientale

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kujdesit ndaj pemëve dhe botës së egër (habitaveve, zhurmës, mbeturinave), veçanërisht në periudha të caktuara. Mund të ofrohet edukim ambientalist.




Sociale

Mundëson një numër më të madh të qasjes në resurset natyrore pa pajisje teknike. Ndikimi në ekonominë lokale.



Vegëza të dobishme

<http://www.parcabout-groix.fr/index-en.php>
<https://vimeo.com/184346812/3df9aabd23>
<http://www.gaialoisirs.fr/>
<http://parcabout.jp/>



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË



Sipërfaqja neto (m2)	Emërtimi	Viti i hapjes	Shtetirja	Vendndodhja	Nr. i vizitorëve/vit
7000	Mangofil	2009		Martinique	10000
605	Montauroux	2014		France (south)	12000
1660	Acrofun	2016		France (center)	13000
1500	Nacturnia	2009	2016	France (east)	40000
3300	Olhain	2015	2016	France (north)	45000
1600	Donjon des cimes	2010	2016	France (west)	15000
1172	Tree Top Treck	2014		UK (Lake District)	30000
1000	Zip World	2014	2016	UK (Wales)	31000

Ku të implementohet?

Ky produkt duhet të ofrojë qasje për tërë publikun. Është një aktivitet që kërkon parashikim të mirë, për të cilin është me rëndësi të madhe “cilësia” e pemëve. Është një produkt i mirë për “zbulimin e natyrës,” prandaj për këtë arsye sugjerojmë Parkun e Gërmisë për implementim.



Parku i Gërmisë

Përshkrimi dhe elementet teknike

Urat dhe shtigjet varëse për lëvizje nga pema në pemë. Dallohen nga rrjetat apo parqet e zbavitjes pasi që më shumë fokusohen në natyrë sesa në zbavitje. Këto pajisje janë projektuar për të nënvizuar rëndësinë e bukurive natyrore; shfaqin një pamje të mrekullueshme të ambientit dhe janë një mënyrë unike për të zbuluar pyllin. Pajisjet e domosdoshme përfshijnë vetëm helmët.

Modeli i biznesit

Çmimi i hyrjes: 15/25€ për fëmijë dhe 25/45€ për të rritur në vendet perëndimore/ USA (1 deri 2 orë aktivitet). Mund të zhvillohen edhe aktivitete të tjera të ngjashme (ushqim, foto suvenir, dyqan dhuratash të artikuljve natyrore, foto artistike, etj.).

Faktorët kyç të suksesit

Respekti për natyrën: ndalohej dëmtimi i pemëve, ndalohej hedhja e mbeturinave, ndalohen bërtitjet me zë të lartë dhe respektohen udhëzimet e sigurisë. Vizitorët mbahen në lokacion përmes aktiviteteve tjera shtesë.

Risqet potenciale

A ekziston ambient i përshtatshëm për këtë lloj aktiviteti? A është pylli i dendur mjaftueshëm dhe i qashtëm?

TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË



Qëndrueshmëria


Ekonomike

Krijimi i vendeve të punës.



Ambientale

Promovon edukim të lehtë ambientalist.




Sociale

Për të gjitha audiencat publike.



Ku të implementohet?

Ashtu si parcabout-et, ky produkt në radhë të parë ka si qëllim zbulimin e natyrës dhe ecjen medituese. Për këtë arsye më i përshtatshëm është Parku i Gërmisë.



Vegëza të dobishme

- <https://www.archdaily.com/551427/a-path-in-the-forest-transsolar-and-tetsuo-kondo-architects>
- <https://www.vancouverattractions.com/capilano-suspension-bridge-park>
- <https://costa-rica-guide.com/activities/suspension-bridge-canopy-tours/>
- <https://whistler.zipirek.com/tours/treetrek/>
- <http://atlantabg.org/about-us/news-blogs/canopy-walk>
- <http://donorthmag.com/features/canopy-tours-in-tupper-lake/>

Përshkrimi dhe elementet teknike

A jeni gati për sensacione të reja? Në një xhiro prej mesatarisht 900 m, me një rënie vertikale prej 50m, do të lundroni në ajër për rreth 2 minuta që do të jetë një përvojë intensive dhe në harmoni me natyrën. Ky litar zinxhir ofron sensacion që vlen po aq sa Grand 8 apo Rollercoaster-at. Shpejtësia tani më nuk është i njëjti kriter. Nga tash e tutje, aventuristëve do t'u duhet t'i sfidojnë ligjet e gravitetit, të flirtojnë me forcën "G", të bëjnë slalom mes pemëve, dhe të zhyten në ajër duke u mbështjellur rreth pemëve. Kufijtë e madhësisë dhe peshës varen nga produkti.

Faktorët kyç të suksesit

Gjatësia e xhiros është avantazh kompetitiv në krahasim me gjatësinë e kabllot. Lokacioni është faktori kyç: pemët, natyra etj.

Risqet potenciale

Zakonisht përdoret si atrakcioni kryesor për të promovuar aktivitete tjera dhe jo si produkt më vete.



Modeli i biznesit

Çmimi paguhet për biletë. Kohëzgjatja e aktivitetit: mes 30 min dhe 1h e 30min (përfshirë pajisjet qasjen, kthimin) +/- 30 njerëz/ h / kablllo për gjatësinë e litarit (1000m). Produkt më profitabilitet të lartë.

TARGETET



ÇIFTE




GRUPE



FAMILJE



INDIVIDË



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Kthim i shpejtë i investimeve.



Ndikimet ambientale

Nuk ka struktura të rënda, apo mjete vizuale që do ta çrregullonin lokacionin. Integrohet për mrekulli me pyllin



Sociale

Krijimi i vendeve të punës për stafin e pakuifikuar.




VENDI	DISTANCA	KOHA E VIZITAVE	INVESTIMI	TARIFA	VIZITORËT
BoL d'Air (France)	900m for 1mn50		€500 000	€500 000	
Forever Florida (USA)	350m		€250 000	\$69 Package	
Treefops (Australia)	330m 1000M		€900 000	\$39 \$79	

Vegëza të dobishme

[http://www.ecoline.com.au/products/rollercoaster-zip-line_\(Leader\)](http://www.ecoline.com.au/products/rollercoaster-zip-line_(Leader))
<http://www.skywab.com/en/products/thrill-adventures/the-rollercoaster-zipline>
<https://www.ziplinesolutionsus.com/systems/avatarone/>

Ku të implementohet?

Mund të zhvillohet pothuajse kudo. E përshtatshme për aventura mbi pemë, dhe po ashtu edhe në shtylla në një ambient të hapur apo edhe të mbyllur.



Përshkrimi dhe elementet teknike

Esenca e një via ferrata moderne është një kablo çeliku e cila do të shtrihet përgjatë shtegut dhe që periodikisht do të përforcohet në shkëmb. Alpinistët mund të mbahen për kablo, duke evituar çfarëdo rënie. Në këtë mënyrë via ferrata mundëson që shtigje që përndryshe janë të rrezikshme, të kalohen pa ndonjë rrezik që ndërlihet me kacavjerrjen apo ngjitjen e pambrojtur. Po ashtu nuk ka nevojë për pajisje të specializuara të alpinizmit. Kjo po ashtu bën të mundur që persona pa përvojë të kënaqen me pozicione dramatike dhe qasje në maja të vështira.



Modeli i biznesit

Ekzistojnë disa burime të mundshme të të ardhurave nga via ferrata. Biletaria në hyrje me furnizimin e pajisjeve apo shoqërimin e vizitorëve, varësisht nga niveli i vështirësisë. Çmimi varet nga gjatësia dhe numri i shtegut.

Faktorët kyç të suksesit

Pikë nisjeje e dukshme, lehtë e qasshme, pikë nisjeje e rrafshhtë. Oferta duhet të përmbajë shtigje me nivele të ndryshme të vështirësisë. Peisazh dhe pikëvështrim të mirë.

Risqet potenciale

Tërheqja e të gjithë llojeve të ekskursionistëve, shumë prej të cilëve fillojnë vonë në mëngjes, shpesh nuk janë të pajisur me pajisje të duhura dhe kanë përvojë të kufizuar.

TARGETET



ÇIFTE



GRUPE

PRIVATPUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË

Qëndrueshmëria

Ekonomike

Via Ferrata nuk stimulon të ardhura dytësore.



Ndikimet ambientale

Vetë parimi i via ferratas është të përzierja në peisazh dhe veçanërisht të mos çrregullohet ambienti.



Sociale

Krijimi i disa vendeve të punës, varësisht nga nevoja e pranisë së udhërrëfyesve.



VENDI	DISTANCA	KOHA E VIZITËS	INVESTIMI	TARIFA	VIZITORËT
Via Ferrata Ari (Kosovo)				15/20 €	
Via Ferrata Berim (Kosovo)					
Mat Via Ferrata (Kosovo)				15/20 €	

Vegëza të dobishme


<https://www.roc-aventure.com/references-de-lentreprise.html>
<http://www.tech-fun.com/en/products/up-high/via-ferratas>
<http://prisme-sa.com/>

Ku të implementohet?

Kosova tashmë ka disa via ferrata. Nëse produkti nuk konsiderohet më inovativ, kemi identifikuar dy lokacone të mundshme për krijimin e shtigjeve të reja. Si prioritet, rekomandojmë themelimin e një Via Ferrata në Prizren, prapa kalasë së qytetit. Ky lokacion ka shumë avantazhe: qasjen e mirë, restaurantet dhe baret në afërsi, parkingjet e veturave, por po ashtu edhe avantazhin e të qenit i dukshëm nga këmbësorët dhe veturat. Opsioni i dytë, do të mund të ishte pak më tutje poshtë rrugës.



Kalaja e Prizrenit



Rrethina e Prizrenit



Përshkrimi dhe elementet teknike

Ky është një fluturim me një balon me ajër të nxehtë i cili është i lidhur për toke. Fluturimi bëhet në lartësi prej 50 metra mbi tokë, duke mundësuar zbulimin e një panorame prej 360°. Zakonisht vendosen 4 udhëtarë në bord plus piloti. Në përgjithësi fluturimi konfirmohet një ditë më herët, varësisht nga kushtet atmosferike. Hapësira në tokë duhet të jetë së paku 80mx80m. Duhet të jetë e mbyllur (qasje e kufizuar për udhëtarët), e dukshme dhe pa pjerrtësi. Nuk ka pajisje teknike specifike për udhëtarët.

Modeli i biznesit

Rreth 20 udhëtarë në orë.
Investimi fillestar: €40,000.

Një ekip prej 4 njerëzve nevojitet për vendosjen e pajisjes. Vendosja e shpejtë (2 orë). Pritshmëria e kthimit të investimeve pas 40 ditësh aktiviteti (4 orë në ditë me një shkallë prej 60% të plotësimi të vendeve). Sponzorizimi është i mundshëm (përmes reklamimit). Në Orlando, fotografitë përbëjnë 20% të qarkullimit të përgjithshëm.

Faktorët kyç të suksesit

Ofrimi i fluturimeve në orare të ndryshme të ditës për të shijuar lindjen dhe perëndimin e diellit, e po ashtu edhe kushtet e mira atmosferike. Cilësia e pamjes nga lart duhet të jetë minimumi i ndotjes së dukshme vizuale (Pa zona industriale apo parkingje të mëdha të veturave, ...)

Risqet potenciale

Lokacioni duhet të përshtatet varësisht nga kufizimet e fluturimit pasi që ky aktivitet varet nga moti: shpejtësia e erës duhet të jetë më pak se 16km/h, është e pamundshme të bëhet fluturimi në shi. Është e domosdoshme të angazhohen njerëz të trajnuar për këtë fluturim: licenca është e obligueshme për pilotin.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Ky aktivitet është një atraksion i rëndësishëm jo vetëm për turistët, por edhe për persona të tjerë kureshtarë që vetëm vijnë të shohin. Për më tepër, orari specifik i operimit rrit kohëzgjatjen e qëndrimit në lokacion apo rreth tij.



Ndikimi ambiental

Ndikimi ambiental është i kufizuar veçanërisht për shkak të lëvizshmërisë së pajisjeve.



Sociale

4 persona janë të nevojshëm për këtë aktivitet.



Linqe të dobishme

<http://aerophile.com/en/>
<https://ultramagic.com/>
<https://www.balLonbau.de/en/>
<http://www.air-pegasus.com/en/services/captive-flights/>
<https://www.youtube.com/watch?v=NEdit09a8Ss>

Ku të implementohet?

Një mënyrë inovative e zbulimit të vendeve speciale nga lartësia. Rekomandojmë zhvillimin e këtij aktiviteti në Ulpianë pasi që është mjaft afër rajonit urban.



Ulpiana



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



FAMILJE



INDIVIDË



Përshkrimi dhe elementet teknike

Mobiliteti elektrik përbëhet nga qiradhënia e bicikletave elektrike apo duke ofruar automjete Seguei. Bicikletat elektrike mundësojnë qasje në klientelë më të gjerë. Segueit kërkojnë një sipërfaqe më të lëmuar të rrugës dhe mund të praktikohen si në grupe, ashtu edhe me udhërrëfyes (Nevojitet një prezantim paraprak i aktivitetit).

Modeli i biznesit

Stafi : punëtorët duhet të gjurmojnë dhe shënojnë shtigjet e reja, pastaj t'i mirëmbajnë ato + disa njerëz për të administruar/fasilituar qiradhënien dhe mirëmbajtjen e bicikletave elektrike + një krijues për shtigjet. Investimi: kostoja totale e parkut të bicikletave në Tignes resort ~ 150,000/200,000€ në vit (investimi dhe operimi). Investimi: bicikletat elektrike duke filluar nga 1400€ +/- 20 bicikleta




Faktorët kyç të suksesit

Bashkëpunimi me komunitetin/ pronarët e tokave për dhënien e qasjes në shtigje. Mirëmbajtja e rregullt Nevojitet shkathtësi teknike në mirëmbajtjen e automjeteve elektrike

Risqet potenciale

Shuma e depozitës mund të jetë e lartë për disa klientë Kostoja e mirëmbajtjes së flotës mund të rritet nëse udhëzimet e sigurisë nuk përfillen plotësisht.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Rryma elektrike mund të ofrohet nga restorantet apo dyqanet, që do të thotë që biciklistët mund të blejnë shërbime/produkte tjera nga ata (qëndrime 1 orëshe) Gjatë periudhës jashtë sezonit, po ashtu mund të shfytëzohet për aktivitete marketingu në rrugë.



Ambientale

Kufizimi emetimeve të dioksidit të karbonit, nëse karikimi bazohet në rrymën elektrike të gjelbërt (mbushje solare?) Zhurmë e ulët krahasuar me automjetet e rregullta.




Sociale

I përshtatshëm për turizëm të ngadalhtë. Ofron mundësinë e zgjerimit të gamës së destinacioneve, jo vetëm tek disa persona specifike.



Vegëza të dobishme

- <http://www.bikesolutions.fr/en/>
- <https://www.biketours.com/electric-bike-tours/>
- <https://www.reeep.org/projects/business-model-solar-charged-e-bikes-vietnam>
- <http://www.segway.fr/>



Ku të implementohet?

Ky lloj aktiviteti mund të praktikohet kudo, edhe pse është më zbatimës në natyrë. Segueit kanë po ashtu avantazhin e të qenit produkt urban.



Përshkrimi dhe elementet teknike

Gjatë verës, rezortet malore mund të ofrojnë aktivitete alternative të rrëshqitjes si BobKart, Tubbing, skutera, saja në rrota/ në binarë apo në pistë... Në disa raste kërkohen pista të dedikuara apostafat (në veçanti për Bobkart). Mund të nevojiten pista mes 200 dhe 2000 metra të gjata, me diferencë në nivel mes 10 dhe 15%.



Modeli i biznesit

Ideja është të kapitalizohet mbi pajisjet ekzistuese (ski liftet) për të ofruar aktivitete verore më minimumun e investimeve të reja. 150 saja/skutera në orë për një kalim (një deri dy orë). Investimi:

- Bob Kart : 2900€ / për njësi.
- Skutera malorë: 1300€ / njësi
- Pistë e tubing: 500€/metër gjatësi (150 000€ për një pistë 300m)



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË

Faktorët kyç të suksesit

Pjerrtësia duhet të jetë e përshtatshme për fillestarët Të ketë një vend të hapur ku prindërit mund të presin gjatë aktivitetit, mundësisht me shërbime ushqimi. Krijimi dhe mirëmbajtja e pistave të dedikuara me këthesa, «pengesa»...

Risqet potenciale

Për arsye sigurie, rrëshqitja me goma (tubbing) nuk është e mundshme në mot me shi apo në kushte klimatike me lagështi.

Qëndrueshmëria

Ekonomike

Të ardhura plotësuese 4-sezonale për pajisjet ekzistuese.



Ndikimet ambientale

Përdoren pajisjet ekzistuese dhe kërkohet pak zbulim i lokacionit.



Sociale

Mundëson që destinacionet tërë-sezonale malore të jenë të hapura për njerëzit që nuk mund të skijojnë.



VENDI	DISTANCA	KOHA E VIZITËS	INVESTIMI	TARIFA	VISITORËT
Devakart Mont du Pila (France)	450m (red) 550m (green) 550m (green)	14h00 to 18h00		€3.5 run	
USled Summer Gemel (Wengen)	+6km long track	Time 30 - 45 minutes	10h00 to 15h45	CHF 29	
Double tubing track in Vilnius (Lithuania)				€6 for 30mn	

Vegëza të dobishme

<http://www.technofun.fr/>
<http://www.tech-fun.com/en/products/down-the-mountain/bob-kart>
<https://www.alpndesign.com/products>
<http://www.skitrax.eu/phpwcms/index.php?new-double-tubing-track>



Ku të implementohet?

Këto produkte janë të destinuara kryesisht për destinacionet/ski resortet ekzistuese për të zgjeruar ofertën e tyre gjatë sezonit të verës.

Është e domosdoshme që pjerrtësitat dhe sipërfaqet të lejojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve, e cila është dhe arsyeja pse Brodi / Arxhena na duket si vendi ideal për këtë lloj produkti.



Brod-Arxhena



Përshkrimi dhe elementet teknike

Rrëshqitja dimërore nuk kufizohet më vetëm në skijim. Ekzistojnë shumë më tepër aktivitete të pazakonta që mund t'i praktikosh gjatë qëndrimit tënd të ardhshëm në mal. Airboardi është një zbulim i çmendur i cili të lejon të marrësh tatëpjetën me një shpejtësi tepër të madhe. Është një mënyrë e re e rrëshqitjes tatëpjetë, mbi borë. Snow Racer, është një sajë me fimon dhe fren. Snake Gliss është një aktivitet "zbavitës"! Të zbresësh tatëpjetën në një varg sajash të ngjitura me njëra-tjetrën. Është një zbritje e çmendur mbi këtë sajë "gjarpër". Qeshjet e zhurmshme janë të garantuara.

Modeli i biznesit

Parimi është që po ashtu të kapitalizohet mbi pajisjet ekzistuese, ski-liftet e vogla apo slitat për fillestarë dhe të zgjerohet oferta për aktivitete rekreative të hapura për të gjithë. Qëllimi është të zgjatet qëndrimi i vizitorëve me anë të pajisjeve të vogla që kërkojnë investim të vogël. Snake Gliss: 150€ për 25 gjarpinj. Fatbikes : duke filluar nga 300€, ato të mirat 900€. Airboard : 150€ (fëmijë), 250€ (të rritur).

Faktorët kyçë të suksesit

Propozimi i shtigjeve specifike dhe/ose kalendareve për kryerjen e këtyre aktiviteteve.

Risqet potenciale

Konflikti i interesit me skijatorët.



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË



Qëndrueshmëria


Ekonomike

Zhvillimi i ofertave plotësuese mbi infrastrukturën ekzistuese, që rezulton në të ardhura shtesë në aktivitet dhe po ashtu në rajon. Këto aktivitete rregullisht organizohen pas ditës së skijimit.



Ndikimet ambientale

Infrastruktura është ekzistuese. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve nuk kërkon punë të madhe. Në fund të sezonit dimëror, nuk do të mbetet gjurmë nga këto aktivitete.



Sociale

Ndikim i vogël në punësimin direkt por po ashtu është e mundshme të zbulohen male dhe aktivitete dimërore për një klientelë të jo-skijatorëve.



Vegëza të dobishme

<http://en.villarddelans.com/luge-ski-park-de-la-colline-des-bains.html#.WseN9UxuLPk>
<http://valcartier.com/en/winter-playground/activities-and-services/slides-and-games/>
<http://www.appeldair-luchon.com/fr/fatbike>



Ku të implementohet?

Këto produkte kryesisht janë të destinuara për ski resortet ekzistuese për të zgjeruar ofertat e tyre. Dy lokacione të identifikuara mund të kryejnë këto aktivitete: Brod / Arxhena, por po ashtu dhe veçanërisht Prevala është një lokacion me interes, pasi që e ka avantazhin e të qenit direkt e qasshme dhe e dukshme nga Prizreni.



Brod-Arxhena



Prevala



Përshkrimi dhe elementet teknike

Ski lifti në ujë mund të instalohet në lloje të ndryshme të trupave ujqorë: liqene, bregdet, lumenj, laguna, penda apo liqene artificiale. Sa i përket përzgjedhjes së lokacionit perfekt për një skijim perfekt në ujë, duhet që lokacioni të ketë klimë perfekte. Sa më të nxehta dhe pa shi që të jenë ditët, aq më mirë do të jetë. Duhet të gjeni një liqen që është së paku 80 m i gjerë dhe 140 m i gjatë. Liqeni në fjalë duhet po ashtu të jetë së paku një metër i thellë, ndërsa rekomandohet 1.3 m.

Modeli i biznesit

Si indikacion, do t'ju duhen 300,000 euro. Kjo shumë do të mbulojë blerjen e sistemit të ski liftit, pagesën e projektimit, dhe shpenzime tjera, si shpimet për ankorime dhe ndërtimi i pikes së nisjes. Rata me orë.

TARGETET



ÇIFTE



GRUPE

PRIVATPUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË

Faktorët kyç të suksesit

Lokacioni: hapësirë me begati të madhe e cila po ashtu ka një klimë të butë me më shumë se 70 ditë me diell në vit.

Risqet potenciale

Është e domosdoshme të studiohet legjislacioni në Kosovë për themelimin e këtij aktiviteti në liqen, apo nësë është e mundur që kjo të bëhet në ndonjë rezervuar të ujit të pijshëm apo pendë hidrocentrale.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Është një aktivitet që gjeneron të ardhura direkte nga pjesëmarrësit, por i cili edhe lejon zhvillimin e shërbimeve tjera në afërsi: bare, restorante, dhe shërbime. Me disa module në liqen, ky aktivitet bëhet spektakolar dhe shumë atraktiv.



Ndikimet ambientaliste

Vetë aktiviteti nuk shpenzon ujë, mirëpo praktikohet në vendet të cilat shpesh janë ruajtur nga ndikimi i njerëzve.



Sociale

Është një aktivitet shumë fotogjenik që i përgjigjet nevojës për ngritje të adrenalines. Ai ofron sensacionin e rrëshqitjes në verë dhe është i hapur për fillestarë.



VENDI	DISTANCA	KAPACITETI	KOHA E VIZITËS	INVESTIMI	TARIFA	VIZITORËT
Wake Park Jarun (Zagreb)	490m long				€2 for 4 hours €4 for 1 hour	
Condrieur (France)	750m	10			€16 30 minutes €25 for 1 hour	




Vegëza të dobishme

- <http://www.cablewake-systems.com/en/about.html>
- <https://www.rixen-cableways.com/en/>
- <https://www.altacableski.nl/>

Ku të implementohet?

Dy liqene duket se i plotësojnë dy kriteret e domosdoshme të afërsisë me qendrën urbane dhe mundësisë për zhvillimin e infrastrukturës (parkingu). I pari është në afërsi të Zubin Potokut, para Liqenit të Gazivodes, afër hidrocentralit. Liqeni i dytë është afër Gjakovës, mirëpo implementimi mund të jetë më kompleks duke pasur parasysh se uji i liqenit përdoret për pije.



Përshkrimi dhe elementet teknike

Është një pajisje e cila e lejon publikun të ecën mbi një shteg të sigurt në zemër të vendeve të jashtëzakonshme, spektakolare, që përndryshe shpesh nuk janë të qasshme. Si një shteg i vetëm, ashtu edhe një shteg i kompletuar i punëve për të zbuluar vendin: ngritja e pjerrtësisë, zbritja, shkallët, ura këmbësorësh të qasshëm për një numër më të madh të njerëzve edhe nëse ndonjëherë mund të jenë marramendëse. Të hapura gjatë gjithë vitit varësisht nga kushtet atmosferike (erë, përmytje, ...)

Modeli i biznesit

Aktiviteti duhet të menaxhohet nga një kompani private. Ndërtimi (varësisht nga vendi) mund të jetë investim publik. Kostoja varet nga kompleksiteti i punës, rreziqet gjeoteknike, gjatësia etj. Renovimi i shtegut 6.6 km të Camino des Rey në Spanjë + parkingu i veturave dhe infrastruktura tjetër kanë kushtuar 5.5M € (2013), për një llogaritje të përafërt të të hyrave në vlerë 20M € në ekonominë lokale/180 vende pune. Hyrja 6€,250,000 vizitorë në vit. Në Monteynard hyrja është pa pagesë.

Faktorët kyçë të suksesit

Bukuria e peisazhit bashkë me karakterin marramandës / Peisazhi dhe integrimi ambiental. Pajtueshmëria me standardet e sigurisë + ndjenja e sigurisë. Mundësia e hapjes gati gjithë vitin. Aktivitete shtesë (Vrojtimi i natyrës, shtegu i kthimit)

Risqet potenciale

Siguria e turistëve: mbajtja e helmetës mund të jetë e obligueshme në gryka. Respektimi i standardeve kombëtare të sigurisë.



Qëndrueshmëria


Ekonomike

Krijimi direkt dhe indirekt i vendeve të punës do të varet nga projekti (atraktiviteti i vendit të zgjedhur dhe cilësia e infrastrukturës)



Ndikimet ambientale

Punimet do të lejojnë një numër të njerëzve të futen në një ambient që është vizituar shumë pak më parë. Punimet do të duhet të përdorin ndihmën e natyrës pa e denaturalizuar atë.



Sociale

I mundëson një numër më të madh të njerëzve qasjen në resurset natyrore pa pajisje teknike. Ndikim në ekonominë lokale.



VENDI	DISTANCA	KOHA E VIZITËS	INVESTIMI	TARIFA	VIZITORËT
Gorges du Fier (Annecy - France)	2 x 800m (vajtje-ardhje)	Mbyllet 3 Muaj (dimër)		€5.70 / bileta	
Camino del Rey (Spain)	6.6km (pjerrt. 2.9km në ura)		Renova' 5.5M€	€6 / bileta	250 000 në vit
Himalayan bridges Monteynard (Isère - France)	2 bridges: 180m & 220m - 45m / 85m të larta	Exposed to the wind	€1.5m HT	Pa pagesë	>500 vis në javë



Vegëza të dobishme Shembuj

- <http://www.lac-monteynard.com/en/1-Home>
- <http://www.caminitodelrey.info/en/>
- <http://www.tianmenshan.com.cn/index.php?m=En&a=index>
- <http://www.tech-fun.com/en/products/up-high/tourism-installations>



Ku të implementohen?

Këto pajisje mundësojnë marshime spektakolare, ecje përgjatë shkëmbinjëve, ecje mbi gryka. Vendet ideale janë patjetër grykat, jo afër njëra-tjetrës, me pamje spektakolare. por lehtë të qasshme. Gryka e Drinit të Bardhë na duket si një vend ideal për të zhvilluar këto shtigje dhe ofron një vend të mirë vrojtimi për t'i lejuar qasjen e publikut te ujvarat.



Gryka e Drinit të Bardhë

Përshkrimi dhe elementet teknike

Skywalk është një shteg këmbësorësh prej xhami i varur në shkëmbinj. Ky aktivitet mundëson ecjen në zbrazëti; që i bije, konkretisht të varesh mbi luginë dhe soditësh peisazhin prej një pikëvështrimi unik që të lë pa frymë. Ofron përvojë të mrekullueshme me një ndjenjë e të qenit i ngritur shumë lart. Kohëzgjatja e aktivitetit: 10 deri 20 minuta në Skywalk; 1h në vendndodhjen e atraksionit turistik.

Modeli i biznesit

Ky është një investim i kushtueshëm. Struktura harkore që del jashtë nga shkëmbi 4500 €/metri. Përveç kësaj, mund të ketë paqartësi pronësore në favor të investimit publik deleguar palës private përmes ndonjë Partneriteti Publiko-Privat. Sektori privat mbulon shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes derisa publiku përfiton nga ndikimi në tërë rajonin përmes fluksit hyrës të turistëve.



Faktorët kyç të suksesit

Nevojitet një strukturë e dalë jashtë marramendëse, e shoqëruar me në pamje të papenguar të panoramës së jashtëzakonshme (pamja përpara dhe përfundi duhet veçanërisht të jenë atraktive). Nevojitet qasje e lehtë tek numri më i madh i njerëzve mbi aksin kryesor.

Risqet potenciale

Numri i personave në shteg duhet të përcaktohet.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Përfitim i ekonomisë lokale për shërbime të shoqëruara (iniciativa private)



Ndikimet ambientale

Integrimi i peisazhit në punë Efektet e strukturës kanë pak ndikim, mirëpo nxit follovinë dhe kërkon pajisje tjera (sanitare, parking, ushqim, etj ...)





Sociale

Krijimi i vendeve të punës për eksplorim.



VENDI	DATA E NDËRTIMIT	INVESTIMET	TARIFA	NUMRI I VIZITORËVE
Grand Canyon (USA)	2007	\$30 000 000	\$30- 50	1500 to 2000 në ditë
Pas dans le vide (Chamonix)	2013	N/A	€20	nuk ka info
Cabo Girão (Madère)	2012		PA PAGESË	1800 jour (?)
Nong Khai (Thailand)	April 2016	17 million baht (€430 000)		20 p për dy përsone



Vegëza të dobishme

<http://www.chamonix.net/francais/loisirs/attractions-touristiques/pas-dans-le-vide>
<https://www.viator.com/fr/fr/7379/Las-Vegas-attractions/Grand-Canyon-Skywalk/d684-a10>
<http://www.comptoir-thailande.com/le-skywalk-de-nong-khai/>
<https://jworgfre.blogspot.fr/2015/02/10-skywalks-terrifiants-dans-le-monde.html>
<https://7lhigna.wordpress.com/2016/12/24/des-vues-spectaculaires-a-des-hauteurs-terrifiantes/>
<http://christophebenichou.com/portfolio-item/basculement/>

Ku të implementohet?

Në vendet të cilat kemi pasur rastin për t'i vizituar deri tani, nuk kemi identifikuar ndonjë lokacion ideal për një pajisje të kështillë.



ZBAVITJET NË QYTET

Përshkrimi dhe elementet teknike

“Escape game” është një koncept i ri i zbatimjes, në të cilin pjesëmarrësit mbylleen brenda një dhome aventure dhe duhet të tentojnë të gjejnë mënyrë e daljes para se të përfundojë koha. E gjithë kjo shpesh kulmon në zbulimin e një çelësi (apo element tjetër) që u lejon atyre të « arratisen nga dhoma». Në ekipe prej 2 deri 6 lojtarë (për dhomë), vihen në lojë shkathtësitë logjike, të observimit dhe imagjinatës me qëllim të zgjidhjes së një morie gjëgjëzash. Ekziston po ashtu edhe një parim i njëjtë “Në natyrë” p.sh. Në Lubjanë (Sloveni) ose në Pyhä resort (Finlandë).

Modeli i biznesit


Hapur gjatë gjithë vitit. Mesatarisht 10-15 € për person për një orë lojë. Investimi fillestar mesatar rreth 100,000€ për një dhomë të arratisë. → mund të kushtojë më pak në Kosovë (për shkak të çmimit të patundshmërive). 1 deri 3 punëtorë. Hapësira e përdorur mund të jetë mjaft e vogël, dhe lojëra tjera inovative në natyrë janë duke u hapur në tërë botën. Kthim shumë i shpejtë i investimit.

Faktorët kyçë të suksesit

- Univers inovativ dhe magjepsës (dekori, lojërat...)
- Ripërtirje e lojërave në baza 18 mujore/ 2 vjeçare (me qëllim të ndërtimit të lojalitetit të klientit)
- Lokacion afër hapësirave me popullsi të dendur apo me fluks të madh të vizitorëve

Risqet potenciale

- Mungesa e komunikimit në fillim (më vonë, mund të funksionojë promovimi “fjala e gojës”)
- Arritje të dobëta që mund të jenë zhgënjyese për klientin



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT

PUBLIK



FAMILJE



INDIVIDË

Qëndrueshmëria


Ekonomike

Struktura kërkon 1 deri 3 njerëz për ta operuar. Mundësi e aktiviteteve shtesë: ushqim, festa ditëlindjes, gara biznesi... Hapur natën dhe në fundjavë.



Ambientale

Ndikim neutral. Mund të implementohet në ndërtesa të braktisura apo jashtë



Sociale

Përkrah barazinë gjinore.



Vegëza të dobishme

- <https://www.challengeyourroom.fr/>
- <http://www.sensas.ms/>
- <https://www.youtube.com/watch?v=vv3VyNCJzx0http://incarna.co/>
- <https://www.youtube.com/watch?v=oUKX5XAp0XU>
- Shembuj
- <http://fun-adventure-ljubljana.si/?lang=en/>
- <https://www.escaperoomsmaster.com/outdoor-escape-experience-a-perfect-tourist-attraction/>
- <http://www.leisureopportunities.co.uk/news/latest-news/536385>

Ku të implementohet?

Lojërat e ikjes mund të luhen si brenda, ashtu edhe jashtë. Megjithatë, ne rekomandojmë verzionet brenda objektit për destinacione si Prishtina, në veçanti për t'u ofruar të rinjve aktivitete në qytet që janë të hapura gjatë gjithë vitit.



Përshkrimi dhe elementet teknike

Është një strukturë ngjitëse e ndërtimit të ulët (3-4 metra e lartë) e cila mund të praktikohet pa ndonjë pajisje. Shtigjet në bllok mund të ndryshohen në mënyrë të vazhdueshme ashtu që klientët e rregullt të mbesin të interesuar dhe t'i vizitojnë më shpesh. Ekziston mundësia e ndërtimit të blloqeve brenda një ndërtese ose edhe brenda dhe jashtë në të njëjtën kohë. Ky aktivitet mund t'u ofrohet turistëve në rast të ditëve më shi apo në mbremje, e po ashtu edhe banorëve lokalë që dëshirojnë të ushtrojnë ngjitjen si hobi.

Modeli i biznesit

Ky aktivitet mund të mbahet nga një kompani apo koncesion (p.sh: The Roof, Akrose, ...). Përdoruesit do të paguajnë kohën e kaluar në bllok apo përmes abonimit. Ekziston mundësia e propozimit të mbajtjes së mësimëve apo trajnimeve të ngjitjes. Eventet rekomandohen shumë me qëllim të shpërndarjes së lajmit dhe për të krijuar raporte të ngrohta mes njerëzve. Po ashtu mund të implementohen aktivitete tjera shtesë (shërbim ushqimi, qiradhënie këpucësh, udhërrëfyes në natyrë, ...). Investimi : <1M €, varësisht nga sipërfaqja dhe çmimet e pasurisë së patundshme.



Faktorët kyç të suksesit

Të jetë afër një qyteti të madh, me qëllim të audiencës sa më të madhe të mundshme

- Të ketë një vend të ushqimit që njerëzit të mund të takohen dhe të bëjnë qejf.
- Investim i madh në komunikim përmes kanaleve të ndryshme (duke përfshirë median sociale dhe zyrën turistike) ... insistimi në faktin që ky aktivitet është zbavitës dhe i qasshëm për të gjithë.

Hapjet dhe tarifat të jenë të përshtatshme për target grupet (përfshirë tarifa atraktive për një hyrje: të përshtatshme si për aktivitetin ashtu edhe për turistët në qëndrim të shkurtër)

Risqet potenciale

- Mungesa e komunikimit në fillim (më vonë, përhapja e fjalëve do të funksionojë)
- Turistët mund të mos kenë pajisjet e tyre → qiramarrja duhet të jetë e lehtë



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



FAMILJE



INDIVIDË

Qëndrueshmëria


Ekonomike

Strukturës i nevojiten së paku 2 ose 3 persona për ta drejtuar + aktivitetet plotësuese.



Ambientale

Nuk ekziston ndonjë problem i integruar ambiental, aktiviteti duhet të vendoset në hangar.



Sociale

I lejon njerëzit të praktikojnë një sport të ri si dhe të socializohen. Blloku është po ashtu një vend i gjallë, ku njerëzit mund të ndajnë me tjerët.



Shembull: Hapur nga e enjta deri të dielën pasdreke deri në ora 10 PM.

PLACE	SESSION'S PRICE	SUBSCRIPTION PRICE
Basalte Evolution	9 ou 10€/ session (limitless time)	135€/ trimestre, 395€/ year
L'ENTREPOT	8,5 € /session (7,50€ for a reduced rate)	115€/ trimestre 340€/ year Reduced rates : 98€ et 280 €



Vegëza të dobishme

- <https://www.climbing.com/places/americas-10-best-climbing-gyms/>
- <http://www.peaksrockclimbing.com/>
- <https://www.dynamicrock.co.uk/>
- <https://www.profitableventure.com/rock-climbing-gym-business-plan/>
- <https://www.arkose.com/en/>

Ku të implementohen?

Aktivitetet e mbyllura, urbane jo në natyrë. Kërkojnë vendosjen në zona të gjera urbane. Fushat industriale të Mitrovicës kanë përparësinë e ofrimit të hapësirave të gjera, lehtë të rihvillueshme, me mundësinë e ofrimit të tavaneve të larta, por në të njëjtën kohë të zhvillohen restorante etj. Ka disa variante të mundshme: Ngjitje fillestare për fëmijë në qendra tregtare, parqe trampolinash, parqe të mbyllura të bicikletave, parqe të mbyllur të zbatimjes për fëmijë...



Mitrovica

Përshkrimi dhe elementet teknike

Ky lloj tjetër i **Selfie** ofron një përvojë vizuale vërtetë unike, duke revolucionarizuar mënyrën e të menduarit për selfit: një video që fillon me një selfi dhe zmadhohet duke përfshirë tërë peisazhin. I jep destinacionit më shumë shikueshmëri në internet dhe zhurmë në rrjetet e tij sociale. Ideja është që klientit t'i ofrohet një video e shkurtër, duke filluar me një pamje të afërt, e cila pastaj përfundon në një pamje të gjerë të tërë zonës, për shembull, një qytet apo një pejsazh natyror. Distanca maksimale prej 250m mes sistemit dhe personave (por edhe në 50m, efekti « wow » është i garantuar. Nevojitet rrjet elektrik. Mesatarisht 2 muaj për ta instaluar.

Modeli i biznesit

Shkarkimi i filmit duhet të jetë ose pa pagesë, ose me një pagesë të vogël. Çmimi i investimit varet nga distanca: Nga 25m-50m deri në 80 metra: 12,000€ + pako/ Nga 80 deri 250 metra: 17000€ + pako. Kompania Skaping ofron shërbimet e saj nga 15000 deri 20000€, përfshirë tarifën e instalimit dhe “pakon e shërbimit të internetit” (interface, hosting, zëvendësimin e kamerës nëse e nevojshme, ...). Kosto shtesë për sistemin e mbledhjes së çmimeve.



Faktorët kyç të suksesit

- Interesi në atë zonë (p.sh. Numri i njerëzve që vijnë dhe interesi për vetë fotografinë)
- Pa lajme të rrejshme, apo pamje që mund të keqprezentojnë zonën (mbeturinat, industria...)

Risqet potenciale

Prishja e qëllimshme e kamerës. Era mund ta ndryshojë këndin e kamerës.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Krijon publicitet për destinacionin që është profitabil për tërë ekonominë turistike.




Ambientale

Nuk ka ndikime ambientale nëse vendoset në një zonë jo te ndjeshme.



Sociale



Vegëza të dobishme

- <https://www.climbing.com/places/americas-10-best-climbing-gyms/>
- <http://www.peaksrockclimbing.com/>
- <https://www.dynamicrock.co.uk/>
- <https://www.profitableventure.com/rock-climbing-gym-business-plan/>
- <https://www.arkose.com/en/>



Ku të implementohet?

Kjo lloj pajisje sot zhvillohet në të gjitha destinacionet turistike, si ato urbane ashtu edhe në natyrë. Kjo gjeneron publicitet dhe shpejt e promovon destinacionin. Një person për shembull mund ta instalojë një xxl selfie në Prizren, dhe fotografia e urës së gurit poshtë, e bërë nga kalaja zmadhohet për ta parë gjithë qytetin.



Përshkrimi dhe elemente teknike

Skydiving brenda objektit është simulim i kushteve të vërteta të rënies së lirë në një tunel ere vertikal. Është vendi ku ëndrra për të fluturuar bëhet realitet. Dhomat standarde të fluturimit variojnë nga 10 deri 22 këmbë (3 to 6.7 metra) në diametër dhe janë të prodhuara nga xhami i lakuar pa korniza mes 4 dhe 8 metra lartësi. Ato mund të ndërtohen si ndërtesa të veçanta apo edhe si pjesë të ndonjë shtëpie mallrash apo objekti tjetër.



Modeli i biznesit

Çmimet fillojnë nga rreth 2,600,000\$ për një model më të vogël që përfshin komponenta të tunelit të erës dhe makinerinë, por jo edhe transportin, instalimin apo furnizimin me pjesë për t'i kthyer elementet përbërëse në ndërtesë të kompletuar.



Faktorët kyç të suksesit

Zhvillimi i aktiviteteve rreth tunelit si dhoma takimesh pune, restorante... Një zonë urbane me një proporcion të lartë të popullsisë nën 40 vjeç

Risqet potenciale

Investim madhor që kërkon kohë për të qenë profitabil varësisht nga kërkesa dhe çmimi.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Është produkt në rritje në botë dhe jashtëzakonisht profitabil përkundër investimit fillestar. Lejon zhvillimin e aktiviteteve shtesë po ashtu.



Ambientale

Një ndërtesë prej 1.000 m² në përdhësë mjafton për një gyp vertikal prej 4.35 metrash në diametër dhe 5.5 metra lartësi, një bar panoramik rreth gypit fluturues, dy dhoma seminaresh, dhoma brifingu rezervuar për ekipet e fluturimit, dhe zyrat administrative.



Sociale

I qasshëm për të gjithë, në zona urbane, por ndoshta elite, varësisht nga çmimi i biletës. Duke filluar nga fëmijët deri në trajnimin e ekipeve të hedhjes së lirë në nivele ndërkombëtare.



Ku të implementohet?

Duhet të instalohet në mes të një zone të gjerë urbane.

Vegëza të dobishme
www.iflyworld.com
<https://indoorskydive.com/en/>
<https://www.weembi.com/>



Përshkrimi dhe elementet teknike

Stadiumet me ujë janë objekte të cilat lejojnë ushtrimin e sporteve të ujit të bardhë (kanu, kajak, noti në ujë të bardhë, raftingu, tubing, hot dog...) brenda një strukture të organizuar dhe të siguruar. Këto projekte shkojnë bashkë me zhvillimin e sporteve në natyrë në një ambient urban. Stadiumet me ujë të bardhë sjellin valë në qytet dhe janë një atraksion i vërtetë. Në portofolion e Hidrostadiumit, Wavestadium zë vendin më "cool". Eficienca e tij energjetike është më e mira në këtë lloj dhe ka karakteristika unike të cilat e bëjnë atë një zgjidhje të mirë për çdo investitor që dëshiron të ketë zgjidhjen më të mirë në treg. Shkalla minimale është 19 x 14 m (të dhënat e ofruara për një valë 10 m). Vala mund të përshtatet në lartësi dhe formë.



Faktorët kyç të suksesit

Ndërtimi i aktiviteteve që lidhen me Wavestadium in si dhoma për takime pune, restaurante... Kërkohej një zonë urbane me një proporcion të lartë të popullsisë nën 40 vjeç

Modeli i biznesit

Një investim substancial (rreth € 1m) që profitabilitetin e tij e gjen vetëm duke iu falëndëruar vëllimit të klientëve të cilin mund ta gjenerojë ky aktivitet. Produkti rrallëherë zhvillohet vetëm, por më shpesh si shtesë në një akuapark ekzistues.

TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



FAMILJE



INDIVIDË



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Produkt i vështirë për t'u shfrytëzuar i vetëm nëse doni të pritni kthim të shpejtë të investimit.




Ambientale

Fillimisht i zhvilluar nga EDF, një furnizues elektriciteti në France që ka ndërtuar stadiume kajaki, konsumi i tij i rrymës elektrike dhe ujit është minimizuar.



Sociale

Ofron mundësinë e një numri më të madh të njerëzve për të zbuluar sërfin edhe kur nuk e kanë mundësinë të shkojnë në oqean.




Vegëzat e dobishme

<http://www.hydrostadium.com/white-water-engineering/?lang=en>
<http://www.citywave.de/>
<https://www.mywaveco.com/>
<https://www.infinitywave.fr/>



Ku të implementohet?

Duhet të instalohet në afërsi të një zone të madhe urbane. Si aktivitet i mbyllur, Prishtina duket të jetë vendi ideal. Alternativë e kësaj mund të jetë zhvillimi i tij afër skilifitit ujqor të përmendur më lartë.



EKSPERIENCAT KULTURORE

Përshkrimi dhe elementet teknike

Kopshti shqisor është një vend ku vizitorët mund të rivedinojnë marrëdhënien e tyre me natyrën përmes të pesë shqisave. Mund të parashihen disa aktivitete si: punëtori ku vizitorët prekin materiale të ndryshme (me duar apo me këmbë); një vend i rezervuar për aroma (Lulet & bimët); një labirint; një shteg këmbëzbathur; një pjesë me serë; një pellg uji apo rezervuar. Përveç këtyre, mund të shtohet një kopsht zërash, një vend gjigant për lojëra dhe vend ku organizohen punëtori (art tokësor, zanat, seanca kulinarie etj.). Fokusi të jetë në varietetet e bimëve/pemëve, të jepen informata lidhur me ruajtjen e tyre dhe t'u mundësojnë vizitorëve të ndryshojnë vizionin e tyre duke përjetuar një mënyrë të re të të parit dhe të përjetuarit (në kopsht botanik klasik, ekziston mundësia e vogël që të preken). E rëndësishme është që bëhet lidhja me specialitetet lokale. Kopshti mund të ndërtohet në etapa (hapësira të reja, rîfreskim i aktiviteteve ...) që të mbahen objektet, të ndërtohen kurse të reja dhe të zhvillohet lojaliteti ndaj klientëve.



Modeli i biznesit

Kopshti hapet gjatë gjithë vitit, duke ndryshuar sipas sezonave. Një ekip prej 6 deri 10 personave është i domosdoshëm për kopshtin (stafi dhe kopshtarët) dhe për aktivitetet shtesë.

Faktorët kyçë të suksesit

Lokacion afër një pike tjetër të interesit lidhur me natyrën Përtëritje e aktivitetit dhe animacioneve në baza vjetore Mirëmbajtja e parkut duhet të jetë e patëmetë.

Risqet potenciale

Mirëmbajtje e dobët apo mungesë e ripërtitjes së ofertës, e cila mund të rezultojë në humbje të shpejtë të atraktivitetit dhe pjesëmarrjes.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Krijimi i gjashtë deri në dhjetë vende pune me orar të plotë (+ kontrata sezonale). Mund të shtohen aktivitete shtesë. Krijimi i efekteve pozitive nëse në afërti të ndonjë aktiviteti tjetër turistik.



Ambientale

Promovon biodiversitet dhe respekt për natyrën (edukim) mes vizitorëve.



Sociale

Hapur për të gjithë, përfshirë shkollat. Shumë kopshte shqisore u përshtaten disa nevojave të veçanta dhe njihen si të dobishme për ta.



TARGETET



ÇIFTE



GRUPE



PRIVAT



PUBLIK



FAMILJE




INDIVIDË



Ku të implementohet?

Vendi ideal për këtë atraksion është Parku i Gërmisë.




Vegëza të dobishme

<https://www.jardin5sens.net/en/>

<http://homekondike.site/2017/01/06/mobile-sensory-garden-what-is-it/>

<http://botanicagardencenter.com/sensory-garden-design/sensory-garden-design-elegant-w-e-carter-school-sensory-garden/>





Përshkrimi dhe elementet teknike

Rrjetet që lidhin nikoqirët e zgjedhur me udhëtarët që janë në kërkim të eksperiencave të thella unike. Nikoqiri ofron ushqime (drekë/ zamër/ darkë/ aperitiv/ piknik/ vakt çaji), mësim për gatim, ose edhe turne ushqimi (vendet më të pëlqyeshme për ture të ushqimeve: dyqanet e degustimit, tregjet lokale, tezgat artizanale dhe vendet tjera speciale). Mysafirët gjejnë një përzgjedhje të nikoqirëve kur zgjedhin vendet, me të cilët ata mund të flasnin para se të rezervojnë shërbimin. Ata zhyten në ushqimin dhe kulturën lokale, takojnë udhëtarë tjerë. Pas përvojës ata e postojnë një kritikë. Në përgjithësi, mysafirët janë një grup prej 6 apo 8 personash në të njëjtën kohë. Kapitalizon mbi reputacionin e cilësisë së mikpritjes kosovare. Mund të lansohet gjatë një festivali të ushqimit/verës.

Modeli i biznesit


Nikoqirët caktojnë vetë çmimin e shërbimeve të tyre. Rrjeti merr një përqindje në secilin transakcion (për lidhjen), rreth 20%. Sigurimi duhet t'i ngarkohet nikoqirit, duke mbuluar si nikoqirin, ashtu edhe mysafirin.

Faktorët kyçë të suksesit

Zgjedhja e mysafirëve: higjiena, lehtësia për t'u gjetur; cilësia e vendeve, ushqimi dhe shërbimi; autenticiteti Kapaciteti për të promovuar rrjetin dhe shërbimet (promocioni, web, dhe përmes fjalëve) Përshtatja e ekonomisë bashkëpunuese me rregullat dhe legjislacionin vendor.

Risqet potenciale

Mungesa e klientëve: ngurrimi/mungesa e zakonit për të përdorur produkte bashkëpunuese; mungesa e udhëtarëve ndërkombëtarë të prirur për ta përdorur shërbimin.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Të ardhura shtesë për mysafirët
Mysafirët mund t'i përshtasin
çmimet



Ambientale

Shërbim i dematerializuar.




Sociale

Ndërveprim kulturor. Mënyrë e
vlerësimit të vlerave të njerëzve.



Vegëza të dobishme

<https://www.eatwith.com/?c=USD>
<https://kinza.life/>
<https://plateculture.com/>
<https://www.meatsharings.com/>
<https://www.smithsonianmag.com/innovation/how-to-get-a-home-cooked-meal-anywhere-in-the-world-3291368/>



Ku të implementohet?

Aktivitet që mund të zhvillohet në secilin qytet.



Përshkrimi dhe elementet teknike

Aktiviteti përbëhet nga një shëtitje natës në park. Parku shënohet me zëra dhe lojëra të lehta për të theksuar pronën lokale. Kjo mund të bëhet poashtu me një audio udhërrëfyes i cili tregon një legjendë apo një tregim lokal. Përgjatë një shtegu të magjepsur, vizitorët ngrohen nga zjarri magjik i tregimit, takojnë krijesa misterioze me lojëra surprize në çdo kënd. Ky aktivitet kërkon ndërtimin e një shtegu në natyrë apo në një vend specifik siç janë gërmadhat e në kështjelle, ose edhe objekte të papërdorura. Për një produkt "Lumina" shtigjet janë +/- 2km të gjate dhe njerëzit mesatarisht rrinë 1h30m.



Modeli i biznesit

Investimi varion nga disa dhjetëra mijëra euro deri në 2 deri 5 milionë për instalacionet më të famshme "Lumina" të kryer nga "Moment factory". Një çmim mesatar mund të jetë 60 deri 100,000€ përveç tokës. 2 deri 4 nisje në natë.

Faktorët kyçë të suksesit

Cilësia e tregimit dhe mjetet e përdorura për ta kthyer atë një një përvojë thellësisht të paharrueshme. Aftësia të ripërthihet tregimi dhe efektet speciale. Nevojiten njerëz me shkathtësi të mëdha për ta dizajnuar konceptin.

Risqet potenciale

Varshmëria e madhe në kushtet atmosferike.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Rreth 10 deri 15 vende pune të krijuara (me/pa përvojë)
Ndikimi në bizneset në afërsi (aktivitet natë)




Ambientale

Ndriçimi duhet të studiohet për të reduktuar ndikimin në se bëhet në natyrë. Njëjtë edhe me zhurmën



Sociale

Aktivitet i ri kulturor për familje, pleq dhe të rinj. Zbulimi i tregimeve dhe legjendave lokale. Vlerësim inovativ i pronës



Vegëza të dobishme

- <https://www.eatwith.com/?c=USD>
- <https://kinza.life/>
- <https://plateculture.com/>
- <https://www.mealsharing.com/>
- <https://www.smithsonianmag.com/innovation/how-to-get-a-home-cooked-meal-anywhere-in-the-world-3291368/>

Ku të implementohet?

Dy lloj lokacionesh janë të përshtatshme për prodhimin e këtij produkti. I pari është pylli; i dyti janë monumentet e njohura: një ecje në pyll nën motivet e legjendave lokale apo ndriçimi i një monumenti dhe trashëgimia e tij historike e kulturore.



Parku i Gërmisë



Kalaja e Prizrenit



Përshkrimi dhe elementet teknike

Qëllimi është të krijohet dhe promovohet një rrjet i aktiviteteve zbuluese: partneritete me prodhues të ndryshëm që u ofrojnë vizitorëve përvoja origjinale. Kjo përfshin vizitat tek artizanët dhe prodhuesit lokalë, me motive të ndryshme (produkte bujqësore, qëndisje, vjelje, zanat, gatim) ku turistët (dhe vendorët) mund të marrin pjesë dhe të krijojnë produkte me duart e veta. Këto aktivitete mund të ofrohen gjatë ditës apo mbrëmjes, gjatë gjithë vitit.

Modeli i biznesit

Puna me rrjetin dhe lëvizja e vizitorit nga pasiv në aktiv lejon një rritje domethënëse në qarkullimin e secilit aktor. Organizata e ngarkuar për animacionin e rrjetit publikon një hartë, fletushka, tabela sinjalizuese dhe vegla komunikuese të internetit. Siguron rezervimin e aktiviteteve. Merret një përqindje (më pak se 5%).



Faktorët kyç të suksesit

Është e domosdoshme të gjenden ofrues të mjaftueshëm për të bërë rrjetin interesant dhe për të promovuar shpërndarjen e fjalëve. Të ruhet autenticiteti i aktiviteteve të propozuara. Kohëzgjatje një-orëshe dhe periudha të hapjes: sigurohet një gatishmëri reale e aktorëve. Me rezervim.

Risqet potenciale

Dispozicioni i ulët apo benefite jo mjaft cilësore (nevojitet animacion dhe menaxhim i vërtetë i rrjetit dhe cilësisë së shërbimit).



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Potencialisht ofron një rritje të vërtetë për aktivitetin sekondar mes artizanëve, fermerëve, etj.





Ambientale

Lejon ofrimin preferencial të produkteve që respektojnë ambientin.



Sociale

Vëmendje për aktorët lokalë dhe produktet e tyre. Lejon shkëmbim njerëzor me anë të të mësuarit. Ofron besueshmëri dhe krenari për prodhuesit duke treguar zanatin e tyre.



Ku të implementohet?

Kudo.



Gjakova

Përshkrimi dhe elementet teknike

Kështjella Guédelon është një projekt një konstruksioni të ri i vendosur në Treigny, France. Objektivi i projektit është të ndërtohet një kështjellë duke përdorur vetëm teknikat dhe materialet e përdorura në mesjetë. Kur të kompletohet në vitin 2020, do të jetë një rekreacion autentik me një kështjellë mesjetare të shekullit 13. Me qëllim të hulumtimit të plotë të teknologjisë së përdorur në të shkuarën, projekti përdor vetëm teknika të ndërtimit, vegla dhe kostume nga periudha në fjalë. Materialet, duke përfshirë drurin dhe gurin, merren në afërsi. Jacques Moulin, arkitekti kryesor i projektit, e ka projektuar kështjellën sipas modelit arkitektural të zhvilluar gjatë shekujve 12 dhe 13 nga Filipi i Dytë i Francës. Ndërtimi ka filluar në vitin 1997. Lokacioni është zgjedhur sipas disponueshmërisë së materialeve të ndërtimit: një gurorë e braktisur, në një pyll të madh, me një pellg uji në afërsi. Lokacioni është në një zonë pyjore rurale dhe qyteti më i afërt është Saint-Sauveur-en-Puisaye, rreth 5 km në verilindje.



Faktorët kyçë të suksesit

Zbatimi dhe respektimi i konceptit.

Risqet potenciale

Gjetja e fuqisë punëtore.

Modeli i biznesit

Turizëm: Vendi i ndërtimit mund të vizitohet. Organizohen turne me udhërrëfyes dhe restorantet mesjetare i presin mysafirët. Lokacioni tashmë është një destinacion i madh turistik, duke qenë atraksioni më i vizituar turistik në Yonne, me më shumë se 300,000 vizitorë në 2010.



Qëndrueshmëria

Ekonomike

Renovimi mbështetet nga aktiviteti indirekt. Vizita e turistëve që vijnë për të zbuluar jetën në kohën e kështjellave. Dyqanet mesjetare që operojat ofrojnë produkte autentike, si të zejes, ashtu edhe të ushqimit dhe pijes. Në fund, vizita me udhërrëfyes edhe për nxënësit e shkollës.



Ambientale

Arkeologjia eksperimentale zbaton një qasje hands-on në testimin e metodave për rizbulimin e teknikave të harruara. Kjo ka filluar kur akademikët vendosën për të eksperimentuar dhe mësuar shkathhtësitë e vjetra vetë, në vend se thjeshtë të mbështeten në hipoteza dhe teori. Një shembull tjetër i kësaj qasjeje është tentimi nga arkeologët për të krijuar veglat prej stralli.



Sociale

Edukative: Projekti është i hapur dhe i përshtatur për grupe dhe ekskursionet shkollash. Njeriu mund të mësojë për kushtet e punës në mesjetë dhe për profesionet e ndryshme të kohës. Shkencë dhe dije: Ekipi i projektit përdor dhe teston njohuritë e shkencëtarëve dhe historianëve lidhur me teknikat mesjetare të ndërtimit. Njerëzore: Në këtë zonë rurale dhe të izoluar, projekti ka krijuar 55 vende pune dhe ka tërhequr 200 vullnetarë. Sociale: Vendi angazhon të rinj me vështirësi, duke u ndihmuar atyre përmes trajnimit gjatë punës profesionale. Për shembull, disa nga ata kanë marrë certifikata për gurgdhendje.



Evolution of the construction since 2000




Vegëza të dobishme
<https://www.guedelon.fr/en/>



Ku të implementohet?

Novobërda dhe kalaja e saj natyrisht është një vend ideal për zhvillimin e një projekti të këtillë.



Novobërda



Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 | 10000 Prishtinë, Kosovo
Tel: +383(0)38220403
email: ppseinfo@swisscontact.org
website: www.ppse-kosovo.org and
www.swisscontact.org/kosovo
www.facebook.com/ppse.kosovo

